



BASHKIA FIER

# BUXHETI I QYTETARËVE FIER





## Mesazh për qytetarin

Buxheti i vitit 2017 i Bashkisë Fier ka për qëllim kryesor vazhdimin e përmirësimit të infrastrukturës rrugore, përmirësimit të sistemit të furnizimit me ujë e kanalizime, përmirësimit të mëtejshëm të shërbimeve publike. Duke patur si qendër të këtij buxheti interesin publik, kemi parashikuar fonde të mjaftueshme për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor nëpërmjet investimeve kapitale.

Ky buxhet do të na sjellë më afër pasi është buxheti juaj.

Për të kontaktuar me Bashkinë dhe për të marrë më shumë informacion lidhur me punët e Bashkisë, ju lutem mund të na vizitoni:  
[www.bashkiafier.gov.al](http://www.bashkiafier.gov.al)

Kryetari i Bashkisë  
Armando Subashi

## **CILAT JANË OBJEKTIVAT E BASHKISË PËR 2017?**

**Vazhdimin  
e përmirësimit  
të infrastrukturës  
rrugore**

**Përmirësimin  
e sistemit të  
furnizimit me ujë  
e kanalizime**

**Përmirësimin  
e mëtejshëm  
të shërbimeve publike**

**Nxitjen  
e zhvillimit ekonomik  
vendor nëpërmjet  
investimeve kapitale**

**Vlerësimin  
e nevojave të  
Komunitetit përmes  
dialogut publik**

**Ofrimin  
e shërbimeve në çdo  
Njësi Administrative në  
standartet dhe cilësinë e  
kërkuar**

**Rritjen  
e transparencës në  
përdorimin e fondeve  
publike**

**Fillimiin  
e likuidimit të detyrimeve  
të prapambetura  
që Bashkia Fier trashëgoi  
nga zbatimi  
i reformës territoriale**

# Fazat e Buxhetit

## PLANIFIKIMI

- ▶ Përgatitja e kërkesave buxhetore nga drejtoritë dhe institucionet e bashkisë
- ▶ Diskutimi në Grupin për Menaxhim Strategjik
- ▶ Hartimi i projektit të parë të buxhetit që përcakton shpenzimet
- ▶ Hartimi i projektit të parë të paketës fiskale që përcakton nivelin e taksave dhe tarifave
- ▶ Konsultimi me qytetarët

## ZBATIMI

- ▶ Shpërndarja e fondeve buxhetore vendore për drejtoritë e bashkisë;
- ▶ Mbledhja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat
- ▶ Financimi i punëve publike dhe monitorimi i tyre
- ▶ Kontrolli i shpenzimeve
- ▶ Rishpërndarja e fondeve dhe rishikimi i buxhetit

## MIRATIMI


- ▶ Paraqitja në Këshillin Bashkiak e projektbuxhetit vjetor dhe projektit të paketës fiskale
- ▶ Diskutim në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Këshillit Bashkiak
- ▶ Diskutim i hapur për publikun në Këshillin Bashkiak
- ▶ Qytetarët mund të marrin pjesë në diskutimin e buxhetit dhe paketës fiskale
- ▶ Miratimi nga Këshilli Bashkiak
- ▶ Publikimi

## KONTROLLI

- ▶ Monitorim nga Kryetari i Bashkisë
- ▶ Monitorim nga Këshilli Bashkiak
- ▶ Auditimi nga njësi e auditimit të brendshëm i Bashkisë
- ▶ Auditimi vjetor i jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit

# Nga vijnë fondet e bashkisë Fier?

## Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë për vitin 2017 janë 1.4 miliard lekë




### Çfarë janë transfertat e pakushtëzuara?

- Janë fonde të dhëna nga qeveria qendrore për të mbështetur bashkinë në kryerjen e funksioneve të veta.

### Çfarë janë fondet specifike?

- Janë fonde të dhëna nga Qeveria qendrore për funksionet e reja që u transferuan në nivel vendor në vitin 2016. Këto funksione janë arsimi fillor, mbrojtja nga zjarri, pyjet, ujitja dhe kullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale

## Të ardhurat nga taksat dhe tarifat bashkiake janë 600 milion lekë



### Çfarë janë taksat dhe tarifat vendore?

**Taksat vendore** - janë pagesa të detyrueshme të përcaktuara me ligj, që bëhen në favor të buxhetit të Bashkisë nga qytetarët dhe komuniteti i biznesit dhe që përdoren për kryerjen e shërbimeve të përgjithshme publike në territorin e Bashkisë.

**Tarifat vendore** - janë pagesa të detyrueshme, të vendosura nga Bashkia, që qytetarët dhe komuniteti i biznesit bëjnë për buxhetin e Bashkisë, për shërbime specifike ose të drejta që ata marrin ose përfitojnë në territorin e Bashkisë.

Bashkia detyrohet me ligj të garantojë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes për taksat dhe tarifat vendore.

# Si i shpenzon Bashkia fondet publike?




Shpenzimet gjithsej për vitin 2017= 1,432,167,000 lekë



**Nëpërmjet Buxhetit për vitin 2017, Bashkia parashikon të ofrojë:**

- Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm
- Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet të zonave të banuara.
- Ndricimin e mjediseve publike
- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit public të varrimit.
- Shërbimin e dekorit publik
- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të arsimit të sistemit shkollor me përjashtim të shkollave profesionale
- Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane
- Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.
- Organizimin e aktiviteteve sportive, clodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- Mbrojtjen e mjedisit.
- Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitës dhe kullimit
- Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore
- Fillimi i likuidimit të disa detyrimeve të prapambetura të trashëguara.




- Administrata
- Arti dhe kultura
- Nderrmarja Komunale
- Pastrimi
- Sporti
- Arsimi

## Shërbime publike

### Llojet

1. Shërbimi i pastrimit dhe i gjelbërimit
2. Menaxhimi i infrastrukturës së rrugëve dhe trotuareve.
3. Ndrëçimi publik
4. Mirëmbajtja e varrezave publike
5. Mirëmbajtje shkollash



- Menaxhimi i infrastrukturës së rrugëve, trotuareve, ndrëçimit publik, etj
- Pastrim dhe gjelbërim

## Shërbimet Sociale

Shuma totale e shpenzimeve për shërbimet sociale, është rreth 19 milion lekë që përbën 1,3% të buxhetit 2017.

Bashkia Fier për vitin 2017 ka parashikuar të realizojë projektet e mëposhtme:

- Ngritja e një qendre multifunksionale që ofron shërbime për gratë në nevojë (gra të dhunuara, kryefamiljare, rome, me aftësi të kufizuara etj).
- Ndërgjegjësim për çështjet e barazisë gjinore nëpërmjet artit.
- Përgatitja e një projekti për mbështetjen e grave në nevojë me biznese sociale me qëllim mbështetjen e një numri të caktuar grash në nevojë për hapjen e një biznesi social.

## Arsimi

1


Në shkollat e qytetit tonë mësojnë 22,000 nxënës të gjitha niveleve të arsimit dhe edukimit.

2

Në vitin 2017 do të shpenzohen rreth **3.3 milion** lekë.

3

Qëllimi kryesor i Bashkisë është ofrimi i shërbimit me cilësi në kopshte, çerdhe, konviktet e arsimit parauniversitar. Po ashtu synohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në sistemin arsimor parauniversitar.



## Sporti dhe Kultura



**Për sportin dhe kulturën do të shpenzohet 4,1% e buxhetit të vitit 2017.**

- Në buxhetin e miratuar për sportin, janë parashikuar të shpenzohen rreth **20 milion** lekë.
- Në buxhetin e miratuar për kulturën janë parashikuar të shpenzohen rreth **39 milion** lekë.



**Objektivat e Bashkisë për sportin gjatë vitit 2017**

- Mbështetja për ekipet e klubit shumësportësh të Fierit:
- Basketboll; çiklizëm; taekondou; volejball; boks; kik-boks; peshëngritje; mundje; shah.
  - Investime për pajisje për mirëmbajtjen e terreneve sportive





## Objektivat e Bashkisë për kulturën gjatë vitit 2017 përqëndrohen në:

- Mirëmbajtjen dhe trajtimin e stafit të Teatrit “Bylis” Fier
- Mirëmbajtjen dhe pastrimin e Muzeut Historik Fier.
- Mirëmbajtjen dhe trajtimin e stafit të Qendrës Kulturore
- Mirëmbajtjen dhe trajtimin e stafit të Bibliotekes Publike Fier dhe Galerisë së Artit Fier.

## Bujqësia dhe Mjedisi (Ujitja dhe Kullimi)

Për bujqësinë dhe mjedisin do të shpenzohet 5,7% e buxhetit të Bashkisë së madhe Fier për vitin 2017. Kjo përqindje përkon me shumën e rreth 82 milion lekë.



Në ujitje dhe kullim do të shpenzohen rreth 53 milion lekë; pra 3,6% e vlerës totale të buxhetit të parashikuar për vitin 2017



Për mbrojtjen nga zjarri dhe administrimi pyjor do të shpenzohen rreth 30 milion lekë; pra 2,1% e vlerës totale të buxhetit të parashikuar për vitin 2017

## Investimet nga Buxheti i Bashkisë 2017

### 166.6 milion lekë

Rik. Bulevardi Jakov Xoxa	35.5 milion lekë
Rikonstruksion i Rrjetit Kanalizimeve të ujërave të zeza në lagjen Sheq i Madh	32.0 milion lekë
Ujësjetllësi Ndërnenas, Hasturkas	21.5 milion lekë
Rikonstruksion Rruga Llukan Toska	16.5 milion lekë
Rikonstruksioni i Ujësjetllesit Gorishovë	11.0 milion lekë
Hartimi I Projektit të Qendrës së Qytetit	10.0 milion lekë
Rik Zgjerim Ura e Sheqit	10.0 milion lekë
Mbikqyrje e Kolaudime Punimesh	9.5 milion lekë
Pagesë për blerje godinë Njësie; kopshti e Qëndër Shendëtësore Mbrostar	7.5 milion lekë
Blerje Pajisje Kompjuterike	7.0 milion lekë
Rikonstruksioni i Ujësjetllesit Vjosë	3.5 milion lekë
Blerje Makineri e Pajisje për UK	1.6 milion lekë
Blerje pajisje për shtëpinë e të moshuarve	1.0 milion lekë

**Totali 166.6 milion lekë**

---

**Për çdo informacion plotësues, mos  
hezitoni të drejtoheni në Bashkia Fier  
ose vizitoni:  
[www.bashkiafier.gov.al](http://www.bashkiafier.gov.al)**

---



**USAID**  
NËNA BOPËLLIMENIKAN

Kjo broshurë u bë e mundur me mbështetjen e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtarë të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtarë dhe u bë e mundur nga Projekti i USAID-it për Përmirësimin dhe Qendrën e Vendore.